



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e Kryetarit

12/02/2024

02/76

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në pajtim me dispozitat e neneve të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe bazuar në nenin 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, Kryetari merr:

V E N D I M

1. Autorizohet z. Gëzim Gashi për përgatitjen, planifikimin dhe zbatimin e politikave financiare, operative dhe logjistike në Shtëpinë e Komunitetit të Shëndetit në Komunën e Shtimes.
2. Marrë parasysh detyrat dhe përgjegjësitë që i bartë pozicioni dhe kërkesat nga z. Gëzim Gashi, bëhet riklasifikimi përkatës në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe atë nga "Profesional 2" në "Profesional 1".
3. Obligohet Zyra e Personelit në Komunën e Shtimes që t'i përfshijë ndryshimet e nevojshme mbi bazën e këtij Vendimi.
4. Vlefshmëria e këtij Vendimi është deri në plotësimin e pozitës në mënyrë të rregullt rekrutuese ose deri në nxjerrjen e një Vendimi të ri.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Iu dërgohet:
Z. Gëzim Gashi
Zyrës së Personelit
në Komunën e Shtimes
Arkivit



Kryetari i Komunës

Qemajl Aliu